



## Republika e Kosovës

### Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

Autoriteti Kosovar të Konkurrencës, në mbështetje të nenit 28 të Ligjit nr 03/L-299, (Gaz.zyr. nr.88/25 Nëntor 2010 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Plotësim ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-226, (Gaz.zyr.nr.17/10 Mars 2014, “Ligji nr. 03/L-149 për shërbyesit civil te Republikës se Kosovës, Statutin e Autoritetit të Konkurrencës se Kosovës Nr. **04-V-312 dt.02.Mars 2012, Komisioni i AKK-së me dt. 10.01.2018** miraton:

### KODI I MIRESJELLJES PËR AUTORITETIN KOSOVAR TE KONKURENCES

#### *Qëllimi* **Neni 1**

Kodi i Mirësjelljes i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (në tekstin e mëtejme Kodi) ka për qëllim të përcaktoj rregullat e sjelljes dhe parimet etike në bazë të cilave punojnë nëpunësit e Autoritetit të Konkurrencës, në përputhje me misionin e këtij institucioni të pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së tij në funksion të ruajtjes dhe afirmimit të standardeve të mirësjelljes si dhe ngritjen e dinjitetit dhe imazhit të tij.

#### *Fusha e zbatimit* **Neni 2**

1. Ky Kod Etike zbatohet për të gjithë nëpunësit e Autoritetit të Konkurrencës.
2. Termi “nëpunësit” në kuptim të këtij kodi përdoret për:
  - a. anëtarët e Komisionit të Konkurrencës,
  - b. nëpunësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil,
  - c. nëpunësit ose bashkëpunëtorët me kontratë të përkohshme.
3. Çdo zyrtar në Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka përgjegjësi t’i bindet ligjit dhe të veproj në mënyrë të ndershme dhe etike. Për këtë arsye, ky Kod është udhëzues, ka për qëllim që t’i njoftojë, nëpunësit për çështjet e veçanta ligjore dhe etike të cilat ngriten shpesh si dhe për mekanizmat e mundshëm për të raportuar sjelljet jo legale dhe jo etike.

*Dispozita të përgjithshme*

**Neni 3**

1. Gjatë ushtrimit të detyrës së tij, nepunesi punon për të arritur standardet më të larta të etikës profesionale e personale në përputhje me legjislacionin e detyrueshëm për zbatim.
2. Dispozitat e këtij Kodi mbështeten dhe plotësojnë parimet e përgjithshme si i drejtësisë, barazisë, ligjshmërisë, paanshmërisë, përgjegjshmërisë, proporcionalitetit, eficientës, mbrojtjes së sekretit shtetëror dhe konfidencialitetit. Parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesit si dhe parime të tjera që janë përcaktuar në Ligjet në fuqi.

*Parime të përgjithshme*

**Neni 4**

1. Nepunesi, kryen detyrat e tij me përgjegjshmëri, profesionalizëm, devotshmëri dhe vendosmëri duke i kushtuar kohën dhe energjinë e duhur.
2. Nepunesi vepron në mënyrë të paanshme, shmang favorizimet e padrejta, dhuratat apo çfarëdo përfitimi tjetër që ndikojnë ose mund të ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrave të tij, si dhe është transparent në marrjen e vendimeve.
3. Nepunesi duhet të ketë kujdes që të shmangë keqkuptimet dhe pasojat negative për reputacionin e institucionit apo të nëpunësve tjerë.
4. Gjatë zbatimit të detyrave të ngarkuara me ligj nepunesi duhet të krijojë një marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi si ndërmjet njëri-tjetrit ashtu edhe midis tij dhe palëve të treta.
5. Për këtë qëllim, si në komunikimin me shkrim edhe në atë verbal, nepunesi duhet të jetë i sjellshëm, i gatshëm për bashkëpunim dhe për tu përgjigjur sa më parë. Nepunesi duhet të përdorë një gjuhë të thjeshtë dhe të arsyetojë përgjigjet, duke bashkëpunuar në njohjen dhe zgjidhjen e çështjeve të ndryshme.

*Ndalimi i diskriminimit*

**Neni 5**

1. Ndalohet çfarëdo lloj diskriminimi I drejteperdrejte apo I terthorte në baze të racës, gjinisë, ngjyrës, gjuhës, fese, moshës, aftësia e kufizuar, mendimeve politike, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, gjendjes ekonomike dhe sociale orientimit seksual ose ndonjë statusi tjetër, në ( të )gjithë veprimtarinë e Autoriteti të Konkurrencës.

*Parimi i paanshmërisë*

**Neni 6**

1. Nëpunesi në ushtrim të funksioneve të tij, trajton në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilët hyn në marrëdhënie.
2. Në ushtrimin e detyrave të tij, nepunesi:
  - a. nuk merr përsipër detyra si dhe nuk jep udhëzime apo premtime në lidhje me çështjet që hyjnë në kompetencën e organeve të Autoritetit;
  - b. nuk merr pjesë në takime jozyrtare me subjekte të interesuar për çështjet në shqyrtim, nëse kjo nuk është autorizuar nga eprori.
  - c. nuk duhet të takojë subjekte të interesuara për veprimtarinë e Autoritetit, përveç rastit kur është i pranishëm të paktën edhe një zyrtar tjetër;

3. Nepunesi i cili ndodhet apo mund të ndodhet në situatat e sipërpërmendura, duhet të informojë eprorin e drejtpërdrejtë Kryetarin ose Komisionin.
4. Nepunesi mund të jetë anëtar i organizatave të ndryshme politike ose jo politike. Në çdo rast pikëpamjet politike të nëpunësit apo mendimet e tij mbi politikën duhet të shprehen qartësisht në mënyrë individuale dhe jo në funksionin e tij si nëpunës i Autoritetit, përveç anetareve të Komisionit që nuk mund të jenë nepunës civil dhe as të ushtrojne apo të merren me aktivitet politik.

### *Konflikti i Interesave*

#### **Neni 7**

1. Anëtari i Komisionit dhe nëpunësi në zbatimin e detyrave të tij, nuk duhet të marrë vendime ose të kryejë veprimtari që përbëjnë konflikt interesi.
2. Në kuptim të këtij Kodi, konflikt interesi është gjendja në të cilën nepunesi ka interesa të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike. Konflikti i interesit, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:
  - a. “Konflikt rast pas rasti interesi” është gjendja me konflikt interesi në njërin nga tri llojet e mëposhtme, që shfaqet rast pas rasti dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë.
  - b. “Konflikt faktik i interesit” është gjendja në të cilën interesat private të nepunësit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të nepunësit.
  - c. “Konflikt në dukje interesi” është gjendja në të cilën interesat e nepunësit duken në pamje ose në formë sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të nepunësit,
  - d. “Konflikt i mundshëm interesi” është gjendja në të cilën interesat e nepunësit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit nëse nepunesi do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.
3. Nepunesi kur gjendet në situatat e sipërpërmendura, i raporton me shkrim eprorit të drejtpërdrejtë, titullarit të njësisë së personelit ose Komisionit, të cilët marrin masat përkatëse, sipas procedurave e modaliteteve të përcaktuara me ligjet në fuqi.

### *Dhuratat apo përfitimet e tjera*

#### **Neni 8**

1. Nepunesi nuk duhet të pranojë për vete apo për të tjerët, dhurata apo mjete të tjera të cilat kanë vlerë ekonomike nga çdo subjekt, interesat e cilit preken, mund të preken apo duket sikur preken nga veprimtaria e Autoritetit, me përjashtim të dhuratave me vlerë simbolike.
2. Për mënyrën e reagimit ndaj dhuratave dhe ofertave, mbahen parasysh kriteret dhe procedurat e parashikuara me Ligji nr.03/L-149 për sherbyesit civil të Republikës së Kosovës, Ligji 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Statutin e Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës ose në rast se shihet e nevojshme të kryhet denoncimi në organet e ndjekjes penale.

## *Mbrojtja e personalitetit të Nepunesit*

### **Neni 9**

1. Çdo nëpunës mbron dhe respekton personalitetin e homologëve, vartësve dhe eprorëve të tij gjatë marrëdhënies së punës. Ai duhet të parandalojë çdo veprim apo qëndrim që cenon dinjitetin e tjerëve.
2. Nepunesi ndalohehet të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim seksual ndaj homologëve, vartësve, eprorëve ose ndaj të tretëve. Në kuptim të këtij Kodi, shqetësim I tille konsiderohet çdo veprim i kryer nga një nepunes i cili kërkon favore të kesaj natyre duke përdorur ndikimin apo pozitën e tij në Autoritet.
3. Nepunesi dhe veçanërisht nepunesit në pozicione drejtuese kujdesen që të mos ketë raste të shqetësimeve të kesaj natyre në punë ose për shkak të punës në Autoritetin e Konkurrencës.
4. Nepunesi raporton menjëherë çdo rast shqetësimi apo dyshimi për një situatë të tillë të Kryetari i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës ose të Komisioni.

## *Përdorimi i informacionit*

### **Neni 10**

1. Nepunesi nuk duhet të përdorë për qëllim përfitimi personal informacionet që siguron apo ka siguruar gjatë kryerjes së detyrës së tij. Kjo vlen edhe pas mbarimit të detyrës për sa kohë që vetë institucioni nuk bën publike të tilla informacione.
2. Nepunesi nuk duhet të nxjerrë jashtë institucionit informacione në lidhje me çështje që po shqyrtohen nga Autoriteti dhe nuk duhet të japë opinione apo gjykime për çështje të tilla, nëse nuk ka autorizimin përkatës nga titullari.
3. Nepunesi nuk duhet të japë informacion që bën të mundur identifikimin e nepunesve të tjerë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë çështje.
4. Nepunesi nuk duhet të japë informacion për masat që janë marrë ose do të merren në lidhje me çështjet në shqyrtim, përpara se ato të jenë miratuar në mënyrë përfundimtare nga Autoriteti dhe t'ju jenë komunikuar zyrtarisht palëve.
5. Nepunesi kujdeset për informacionin që siguron apo ka siguruar për shkak të detyrës duke:
  - a. E ruajtur në mënyrë të sigurt;
  - b. Diskutuar për këtë informacion vetëm me nëpunës të tjerë të Autoritetit të Konkurrencës të cilëve i duhet për të kryer detyrën e tij.

## *Marrëdhëniet me organet e medias së shkruar dhe elektronike*

### **Neni 11**

1. Nepunesit mund të bëjnë deklarime publike në lidhje me probleme të përgjithshme të konkurrencës apo të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Këto deklarime nuk duhet të paragjykojnë veprimtarinë e hetimit e të vendimmarrjes të Sekretariatit e Komisionit të Konkurrencës.
2. Për sqarime të kërkuara nga ana e organeve të medias në lidhje me veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës, duhet të informohet menjëherë eprori Kryetari ose Komisioni i Konkurrencës.

### *Profesionalizmi*

#### **Neni 12**

1. Zbatimi i Standardeve të larta profesionale, vet-disiplinës, mirësjelljes individuale si dhe efektiviteti operacional, ndikojnë në reputacionin dhe besueshmërinë e qytetarëve në Institucionin e Autoritetit të Konkurrencës.
2. Përveç kryerjes së detyrave të ngarkuara me përgjegjësi, profesionalizmi përfshinë edhe sjelljen e nëpunësve, dhe përkushtimin ndaj bashkëpunësuarëve të institucionit në përgjithësi si dhe palëve apo bashkëbiseduesve të tjerë jashtë institucionit (gjate orarit të punës).
3. Sjellja individuale dhe grupe bazohet në raportet korrekte dhe profesionale ndër- njerëzore, respektin dhe besimin e ndërsjelle, përkushtimin ndaj detyrës si dhe vetëdijen për sa i përket ndërvarësisë dhe solidaritetit në kryerjen e të gjitha detyrave dhe aktiviteteve të Institucionit.

### *Ndershmëria dhe transparenca*

#### **Neni 13**

1. Pjesëtarët e Institucionit të Autoritetit të Konkurrencës duhet të veprojnë me çiltërsi dhe ndershmëri dhe duhet të jenë korrekt dhe transparent në raport me të tjerët, përveç rasteve kur kërkohet ruajtja e fshehtësisë zyrtare / konfidencialitetit që e kanë në zotërim.
2. Pjesëtarët e Institucionit të Autoritetit të Konkurrencës duhet të veprojnë të udhëhequr nga ndjenja e përgjegjësisë dhe t'i kryejnë të gjitha detyrat në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të disiplinuar, më nder dhe integritet të lart përkundër të gjitha vështirësive apo rreziqeve të ndërlydhura si dhe në komunikimet e tyre të jenë të drejt dhe të sinqertë.

### *Veprimtari të tjera*

#### **Neni 14**

Nepunësi nuk mund të zhvillojë veprimtari që janë haptazi në kundërshtim me përmbushjen e detyrave funksionale të tij.

### *Sjellja në jetën sociale*

#### **Neni 15**

1. Nepunësi nuk duhet të përdori pozitën që ka në Autoritet për të përfituar të mira që nuk i takojnë. Në marrëdhëniet me të tretët, eviton të deklarojë ose të nënkuptojë këtë pozitë në të gjitha rastet kur nuk i përgjigjet kërkesave objektive.
2. Nepunësi nuk kërkon asnjë përfitim personal që nuk i takon në bazë të ligjit, nëpërmjet përdorimit të statusit të tij si nëpunës i Autoritetit.  
Nepunësi nuk hyn në marrëdhënie që mund të komprometojnë pavarësinë e gjyqimit të tij me persona të cilët lidhen me çështjet që Autoriteti ka në shqyrtim.

*Mbrojtja e aseteve të institucionit*

**Neni 16**

1. Të gjithë nëpunësitë duhet të kujdesen për mbrojtjen e aseteve dhe përdorimin eficient të tyre.

*Sanksionet dhe detyrimi për informim*

**Neni 17**

1. Çdo nëpunës, është i detyruar të njohë dhe të zbatojë këtë Kod në ushtrimin e funksioneve të tij. Shkelja e rregullave të këtij kodi sjell përgjegjësi disiplinore sipas legjislacionit përkatës e në veçanti”, Ligji nr. 03/L-149 për sherbyesit civil të Republikës së Kosovës, Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës 04/2015, Ligji 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Ligjin nr. 02/L-28 për procedurë administrative”. Statutin e Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës Nr. 04-V-312 dt.02.Mars 2012.
2. Çdo nëpunës, është i detyruar të informojë Kryetarin - Komisionin ose Sekretarin e institucionit të AKK për çdo shkelje ose dyshim për shkelje të këtij Kodi.
3. Udhëheqësi i drejtpërdrejt i nëpunësit ka përgjegjësi të kontrolloi dhe propozoi ose të marre masat e duhura disiplinore për shkelje të këtij kodi.

*Hyrja në fuqi*

**Neni 18**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

**KOMISIONI I  
AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS**

(\_\_\_\_\_)

Valon Prestreshi

Kryetar

(\_\_\_\_\_)

Ahmet Krasniqi  
Zëvendëskryetar

(\_\_\_\_\_)

Fatime Haziri  
Anëtare

(\_\_\_\_\_)

Muhamed Krasniqi  
Anëtar

(\_\_\_\_\_)

Shaqir Morina  
Anëtar

Prishtine, 01/2018